



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1099/prot
/2

Tiranë më 15 . 7 .2022

VENDIM

Nr. 26 datë 21 . 06 .2022

**“PËR MIRATIMIN E PROJEKT RAPORTIT TË AUDITIMIT REALIZUAR
PRANË FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA TË UT“**

Në mbështetje të neneve 3 pika 3/c, 47, 49 e në vijim të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neneve 8, 14, e në vijim të Ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik”, neni 12 “Përgjegjësia e titullarit të njësisë publike”, bazuar në planin vjetor 2022, për Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm të UT, miratuar me Vendimin nr.41, datë 25.10.2021, të Bordit të Administrimit të Universitetit të Tiranës,

VENDOSI:

4. Miratimin e Projekt Raportit të auditimit me objekt “*Auditim i përputhshmërisë dhe financiar*” të aktivitetit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, për periudhën 01.01.2019 deri më 31.12.2020, realizuar në zbatim të programit të auditimit nr.prot. 1099/1, datë 13.04.2022 “Për angazhimin e auditimit për Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës”,
5. Ky Projekt Raportit i përcillet zyrtarisht Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës për njohje dhe paraqitje observacionesh.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

